



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0316489/26 dt. 30.03.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 pika (f) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe nenin 20 të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Kërkesën Elektronike të dt. 27.03.2026, nga z. Shkelzen Haliti - Zyra e Kryetarit, Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M

(Për emërimin e Zyrtaresve Përgjegjëse për Trajtimin dhe Zgjidhjen e Situatave të Konfliktit të Interesit)

- Emërohen** Zyrtares Përgjegjëse për Trajtimin dhe Zgjidhjen e Situatave të Konfliktit të Interesit për Komunën e Mitrovicës së Jugut, si në vijim:
1.1 znj. Hanife Rushiti Hakaj, Udhëheqëse e Qendrës për Shërbim me Qytatar;
1.2 znj. Valbone Peci, Zyrtares e Personelit, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.
- Zyrtares e emëruara sipas pikës një (1) të këtij Vendimi janë të obliguara që të bëjnë trajtimin dhe zgjidhjen e situatave të Konfliktit të Interesit për Komunën e Mitrovicës së Jugut konform dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi nga fusha përkatëse.
- Për rastet e trajtuara obligohen që t'i raportojnë Kryetarit të Komunës dhe Agjencisë Kundër Korrupsionit në Kosovë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
- Mandati i zyrtarëve të emëruara është 2 (dy) vjeçar.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

T'i dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Agjencisë Kundër Korrupsionit
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 znj. Hanife Rushiti Hakaj
- 1x1 znj. Valbone Peci
- 1x1 Arkivit

